



Republika e Kosovës  
Municipality of Istog  
Republika Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Republic of Kosovo

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Istog shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë të Ekonomisë
<b>Institucioni</b>	Komuna Istog
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010459
<b>Kodi</b>	RPC0004137
<b>Data e njoftimit</b>	21.11.2022
<b>Afati për aplikim</b>	12.12.2022 - 20.12.2022

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Bënë pranimin e aplikacioneve për regjistrim fillestar të biznesit, ndryshimet dhe shuarjen e biznesit;
2. Bënë përpunimin e të dhënave për regjistrim të bizneseve dhe emrave tregtarë;
3. Kryen kontrollimin e të dhënave në aplikacionet për regjistrim të bizneseve ose emrave tregtarë të dorëzuara nga biznesi dhe bëjnë validimin e emrit të biznesit ;
4. Bënë futjen e të dhënave në sistemin e para regjistrimit në bazë të tipareve të biznesit;
5. Krijon arkivin elektronik në para regjistrim duke skanuar dokumentacionin ;
6. Ofron këshilla për aplikuesit e bizneseve – regjistrimin e tyre sipas kërkesave të tyre;
7. Kryen edhe detyra tjera që caktohen nga DEZH në pajtim me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

Arsimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare, Fakulteti Ekonomik dhe i Biznesit, me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;

- Kualifikime të posaçme formale ;
- Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet përvojë pune.



#### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

#### 5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0003989	RN00010294	Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve	Profesional 3	7	Komuna Istog	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim / Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

#### 6. Mënyra e aplikimit

---

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

#### 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- · Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- · Kopjet e dëshmisë së punësimit
- · Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- · Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- · Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende
- · Dëshminë që nuk jeni nën hetime ( nga gjykata ).

#### 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Njohuri profesionale për fushën në të cilën zhvillohet konkurrimi;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.  
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.  
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

